



Prishtinë, 29.07.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1561\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2320\_06\_22** i dt.21.06.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **07.07.2022**;

në seancën e mbajtur më datë 29.07.2022 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin B. A., nga komuna e Prishtinës, si e pa bazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2320\_06\_22, i datës 21.06.2022.

## A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 21.06.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2320\_06\_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit B. A., dhe e ka obliguar KESCO-n që të bëjë korigjimin e faturimit nga periudha 07/2008 deri në periudhën 05/2022.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën 02/2022 është i saktë dhe i njëjti është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsor.
- Faturimi i gjendjeve të regjistruara në njehsor është bërë sipas tarifave NT=94263 kWh dhe HT=59857 kWh.
- ZRrE/DMK vendimin e saj e bazon në foto të njehsorit nr.30367740 nga ku ka konstatuar që nuk është bërë faturimi i saktë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor, përkatësisht sipas kohës tarifore për të cilën konsumatori ka bërë shpenzim.
- Konsumatori nuk e ka kontestuar faturimin për periudhën e kaluar 2008-2022 por vetëm faturimin për periudhën 02/2022.



- Nëse shpenzimi i matur në tarifa ka qenë sipas strukturës tarifore/kohës tarifore 22-07, 07-22 gjatë sezonës së dimrit dhe orës 23-08, 08-23 gjatë sezonës verore do të ishte normale të bëhen korrigjimet, në të kundërtën çdo ri kalkulim do të ishte gabim pasi nuk bazohet në shpenzimin real sipas kohës tarifore.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2320\_06\_22 i datës 21.06.2022 për konsumatorin B. A.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pretendimit se faturimi për periudhën 02/2022 është i saktë, ZRRE ka analizuar faturat nr.0222122DPR-29799 dhe nr.0222222DPR-29799 datë 22.02.2022 të konsumatorit dhe konstaton se KESCO për faturimin e shpenzimeve të periudhës shkurt 2022 ka bërë ndarjen e shpenzimeve në dy fatura. Kjo ndarje është bërë duke marrë për bazë shpenzimin total mujor për periudhën 24.01.2022 deri në periudhën 22.02.2022, i cili pastaj është pjesëtuar me periudhën 29 ditore sa zgjat cikli mujor i shpenzimit dhe të njëjtin e ka ndarë për dy periudha. Periudha e parë e faturimit përfshin periudhën nga data 24.01.2022 deri në periudhën 08.02.2022 (15 ditë) kurse periudha e dytë përfshin periudhën 09.02.2022 deri në periudhën 22.02.2022 (14 ditë). Sipas listave të leximit dhe rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimi total i konsumatorit për periudhën shkurt 2022 (29 ditë) është **2,599 kWh** (TL=1,604 kWh dhe TU=995 kWh) dhe si shpenzim ditor i konsumatorit është marrë TL= 55.31 kWh dhe TU=34.31 kWh dhe i njëjti është llogaritur për dy periudhat. Për periudhën 24.01.2022 deri me 08.02.2022 (15 ditë) është faturuar shpenzimi TL=829 kWh dhe TU=514 kWh me tarifat e vjetra kurse për periudhën 09.02.2022 deri në periudhën 22.02.2022 (14 ditë) është faturuar shpenzimi TL=775 kWh dhe TU=481 kWh duke e ndarë shpenzimin në dy blloqe (Blloku i parë 0-800 TL=493.63 kWh dhe TU=306.37 kWh kurse blloku i dytë 800 TL=281.37 kWh dhe TU=174.63 kWh).

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 22.02.2022 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2022 (faturat nr.0222122DPR-29799 dhe nr.0222222DPR-29799) me **2,599 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **173.07€**. I pakënaqur me faturimin nga KESCO, me datë 22.02.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturave për periudhën shkurt 2022 (nr.0222122DPR-29799 dhe nr.0222222DPR-29799) për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 30367740. Ndërkaq, KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, leximeve të rregullta mujore si dhe ka informuar konsumatorin se cikli i leximit mujor është 29 ditë, prej të cilave 15 ditë janë faturuar me tarifat e vjetra dhe 14 ditë sipas tarifave të reja e të cilat janë në fuqi nga data 09.02.2022. Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit si dhe fotografinë të cilën e ka prezantuar konsumatori për njehsorin elektrik nr. 30367740 dhe konstaton se konsumatori nga periudha 07/2008 deri më tani nuk ka faturim të saktë të shpenzimeve të shkaktuara, përkatësisht shpenzimet e faturuara nuk reflektojnë kohën tarifore për të cilën konsumatori ka bërë shpenzim.



ZRRR ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike, sipas së cilës shpenzimet e regjistruara në tarifën e lartë janë faturuar si shpenzime në tarifën e ulët si dhe shpenzimet e regjistruara në tarifën e ulët janë faturuar si shpenzime në tarifën e lartë. Kjo gjendje është përmirësuar në listat e leximit të periudhës 05/2022 por që nuk ka reflektuar edhe në rrjedhën e energjisë (CCP) andaj edhe KESCO duhet t'i bëjë të gjitha përmirësimet e nevojshme, përfshi edhe korigjimet.

Rrjedhimisht, bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO me rastin e faturimit të shpenzimeve për konsumatorin nga periudha 07/2008 deri në periudhën 05/2022 nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

Bordi i ZRRR, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në kundërshtimin e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në kundërshtim vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRR-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRR-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit B. A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.